



## Informata për projektin

Emërtimi i projektit:	"Llogaridhënia për kornizat mjedisore komunale"
Vlera e projektit:	€ 19,870.00
Kohëzgjatja:	Data e fillimit: 01/10/2016 Data e përfundimit: 31/07/2017
Organizata:	Lets Do It Peja
Kontaktet e OJQ-së (adresa, email, telefonat, faqja e internetit):	<a href="mailto:letsdoitpeja@gmail.com">letsdoitpeja@gmail.com</a> ; +386 49 124 548; Shtëpia e Kulturës, kati III, Pejë <a href="http://www.letsdoitpeja.org">www.letsdoitpeja.org</a>
Përfituesi i drejtpërdrejtë:	Grupi i synuar: Organet legjislativë dhe ekzekutive të komunës së Pejës dhe Gjakovës Përfituesit përfundimtar: Qytetarët e bashkësive lokale të komunës së Pejës dhe Gjakovës janë përfituesit e drejtpërdrejtë, duke përfshirë zyrat e kryetarëve të komunave, kuvendet komunale, drejtorët e departamenteve dhe ndërmarrjet publike që merren me mjedis. Zbatimi i sundimit të ligjit për çështjet e mbrojtjes së mjedisit mund ta përfshijë secilin, duke filluar nga qytetarët, pushteti lokal dhe inspektorët e tij, si dhe policinë.
Partnerët (nëse ka):	N/A
Zona e synuar:	Komuna e Pejës dhe ajo e Gjakovës
Objekti i përgjithshëm:	Qëllimi i këtij projekti është rritja e llogaridhënies së komunës për obligimet e tyre ligjore në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, duke rritur njëkohësisht përfshirjen e qytetarëve. Përmes këtij projekti do të përfshihen qytetarët, pushteti lokal dhe një OJQ për mbrojtjen e mjedisit në dy strategji të rëndësishme për avokim mjedisor. Në Pejë, përmes një vlerësimi të Planit aktual Lokal për Veprim Mjedisor (PLVM) do të njoftohen qytetarët dhe vendimmarrësit për atë se çka është arritur që nga hartimi i planit në vitin 2009, dhe çka mbetet për t'u bërë. Personat përgjegjës për të do të njoftohen përmes raporteve, ngjarjeve publike dhe angazhimit aktiv të qytetarëve. Në Gjakovë do të krijohet dhe realizohet një model i suksesshëm i Komisionit konsultativ mjedisor në bashkëpunim me pushtetin lokal.
Aktivitetet:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizimi i intervistave, shqyrtimi i dokumenteve dhe zbatimi i hulumtimeve për të përcaktuar gjendjen e tanishme të çdo prioriteti strategjik të PLVM-së aktuale në komunën e Pejës.</li> <li>2. Hartimi i raportit për 9 prioritetet strategjike të PLVM-së aktuale;</li> <li>3. Realizimi i intervistave, shqyrtimi i dokumenteve dhe zbatimi i hulumtimeve për përcaktimin e gjendjes aktuale të çdo plani të veprimit;</li> <li>4. Hartimi i raportit për gjendjen e Planit të veprimit 24 në PLVM-në aktuale;</li> <li>5. Organizimi i punëtorisë dyditore për paraqitjen e të gjeturave;</li> <li>6. Publikimi i kartës vlerësuese të raportit të prioriteteve strategjike të PLVM-së dhe të Planit të veprimit;</li> <li>7. Prezantimi i kartës vlerësuese të raportit të PLVM-së Kuvendit Komunal të Pejës;</li> <li>8. Prezantimi para anëtarëve të Kuvendit Komunal të Gjakovës për rolin dhe funksionin e Komisionit konsultativ;</li> <li>9. Organizim i punëtorisë njoftuese gjysmëditore për rolin juridik të anëtarëve të Komisionit;</li> <li>10. Organizimi i punëtorisë dyditore për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit konsultativ (5-9 anëtarë), kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe këshilltarin juridik të KK-së lidhur me rolin, funksionin dhe përgjegjësinë e Komisionit konsultativ TeR (Termet e Referencës), kornizën nacionale ligjore dhe rregulluese, standardet ndërkombëtare mjedisore dhe direktivat e BE-së, ndarjen e përvojës me Komisionin konsultativ të Pejës;</li> <li>11. Hartimi i pakove për komunikata të shtypit &amp; mediet publike;</li> <li>12. Konferenca për shtyp me pjesëmarrje të medieve, zyrtarëve të pushtetit lokal, qytetarëve dhe OJQ-ve për mbrojtjen e mjedisit;</li> <li>13. Krijimi i vegëzave apo linqeve për kartën e raportit në faqen e internetit të komunës dhe të LDIP, si dhe në rrjetet e tjera sociale;</li> </ol>



Rezultatet:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Raporti për gjendjen aktuale të secilit prej nëntë (9) prioriteteve strategjike të Planit aktual Lokal për Veprim Mjedisor (PLVM) të komunës së Pejës.</li> <li>2. Raporti për gjendjen aktuale të çdo pike të PLVM-së aktual. Plani i veprimit përmban njëzet e tetë (28) veprime specifike në fushën e ujit, ajrit, tokës, biosferës, terreneve malore dhe ekosistemeve specifike, mjedisit socio-ekonomik dhe turizmit, si dhe përfshin prioritetizimin dhe palët përgjegjëse për çdo veprim.</li> <li>3. Punëtorja dyditore me kryetarin e komunës, kuvendin komunal (udhëheqësit e grupeve), anëtarët e Komisionit konsultativ dhe drejtorët e departamenteve me qëllim të diskutimit të rezultateve dhe pranimit të komenteve për prioritetet strategjike dhe për ricaktimin e prioriteteve të Planit të veprimit sipas nevojës. Kjo do të rezultonte me Planin e rishikuar të veprimit të PLVM-së së Pejës;</li> <li>4. Themelimi i Komisionit komunal konsultativ mjedisor të komunës së Gjakovës, duke u bazuar në përvojën e komunës nga fusha e mbrojtjes mjedisore si një fushë me rëndësi jetike për zhvillimin e politikave publike mjedisore dhe angazhimin e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes;</li> <li>5. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rolin e komunës dhe përgjegjësitë e saj në zbatimin e dispozitave ligjore dhe rregulluese nga fusha e mbrojtjes mjedisore, duke përfunduar kështu një cikël të mirëfilltë të projektit.</li> </ol>
-------------	---